

# 21

## Projekte të cilat janë veçanërisht të përshtatshme për bashkëpunim me mësimin e rregullt

### Qëllimi

Nga shumë shkolla dhe mësimdhënës shtjellohen tema ndërkulturore; edhe shumëgjuhësia e klasëve të sotme gjithnjë e më shumë po tematizohet. Këtu krijohen pikënisje optimale për një bashkëpunim mes mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe mësimin të rregullt. Me rëndësi është që edhe mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes të marrin iniciativën. Propozimet vijuese do t'u përshtaten sigurisht edhe kolegëve/leve të mësimin të klasëve të rregullta.

### 1. Përmbledhje e poezive shumëgjuhësore (njëmbëdhjetëshe etj.)

nga klasa e 2

Info të tjera:  
Faqe të ndryshme interneti  
për njëmbëdhjetëshet  
dhe Haiku

Ky projekt është realizuar në shumë shkolla. N merren me poezitë, sajojnë vetë poezi të thjeshta, i formojnë bukur ato dhe i prezantojnë në formë të një ekspozite apo të një libri. Nëse ekspozita ose libri përmban edhe poezi në gjuhë të tjera (mundësisht me përkthim në gjuhën shkollore), është aq më mirë. Për të sajuar vetë, më së miri është i përshtatshëm «plani ndërtues» i poezive – njëmbëdhjetëshe. Ato ndërtohen nga njëmbëdhjetë fjalë, të cilat ndahen në 5 rreshta të tillë:

i kaltër  
ky liqen  
shkëlqen plot dritë  
unë notoj me qejf  
verë

Rrjeshti 1:  
1 fjalë (mbiemër, event. emër),  
p.sh. një ngjyrë, ndjenjë.

Rrjeshti 2:  
2 fjalë (emra me mbaresë)  
(çfarë është, për çka flitet ...)

Rrjeshti 3:  
3 fjalë (fjali e shkurtër dëftore)  
(çfarë bën?)

Rrjeshti 4:  
4 fjalë (fjali e shkurtër me unë)  
(çfarë bën ti?)

Rrjeshti 5:  
1 fjalë (mbiemër)  
(më e rëndësishmja në një fjalë)

### 2. Libra të ilustruar shumëgjuhësor

cikli i ulët

#### ose libra aventurë

cikli i mesëm

Udhëzim për literaturë:  
Schader (2012a):  
Sprachenvielfalt als Chance,  
(Shumëgjuhësia si shansë)  
f. 188ff.

Në ciklin e ulët shpesh krijohen libra të ilustruar sipas planit vijues:

- N e lexojnë ose e sajojnë një tregim,
- Ata e ndajnë në episode veç e veç gjegjësisht në ilustrime
- Një ose dy N e vizatojnë një skenë dhe nën të e shkruajnë veprimin përkatës
- Fletët ngjiten ose lidhen bashkë, kështu bëhet një libër i ilustruar i bërë vetë.

Kjo rrjedhë lë pa problem mundësinë për ta zgjeruar në shumëgjuhësi, nëse rreth e rreth ilustrimeve lihet vend, ashtu që p.sh. ilustrimi mund të shkruhet në katër gjuhë. Kështu krijohet një libër i ilustruar shumëgjuhësor, ku mësimi në gjuhën e prejardhjes mund të japë një kontribut të mirë.

Në ciklin e mesëm mund të krijohen libra aventurë «shumëgjuhësor», në të cilët N së pari p.sh. i sajojnë dy personazhe kryesore, të cilët përjetojnë aventura të ndryshme. Nga 1–2 N përshkruajnë pastaj një episod; kur merren së bashku atëherë japin një libër të përgjithshëm aventurë. Do të bëhet shumëgjuhësor, nëse si paracaktim p.sh. merren vesh që episode të veçanta duhet të zhvillohen në vendin e prejardhjes së N dhe në secilin episod duhet të vijë në shprehje disa fjalë të gjuhës së atjeshme (p.sh. «mirëdita», «faleminderit» etj.).